

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Hoxha nga Nju Jorku: Bashkëpunimi rajonal, domosdoshmëri për sigurinë dhe mirëqenien në Ballkanin Perëndimor
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/hoxha-nga-nju-jorku-bashkepunimi-rajonal-domosdoshme-ri-per-sigurine-dhe-i588332
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 12:51:55 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 12:51:16 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a666b5729f08a2e6683d45dc09f4ed9b0e3bb7daa65830f29fafee2f73a56f87
TEKSTI	6b243741c493d8123973b162e0531bf59e22cc3d6f80d0cd37f2966ab91c363c
PAMJA	91a59e9075e0cd43ea4a1ded794ea828678d4a77425277aeb5ef37ac3e42d942

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d632b5d2221f2833524464e51e61be031ff383c6b4b9c92c923f0f7ba71c81c3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7ef11613d0a46fe814f564609ee7439753917635a3984a70b661e478103337ad
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d632b5d2221f2833524464e51e61be031ff383c6b4b9c92c923f0f7ba71c81c3>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by [Kontakt](#)



English



ie [Hoxha nga Nju Jorku: Bashkëpunimi rajonal, domosdoshmëri për sigurinë dhe mirëqenien në Ballkanin Perëndimor](#) Gushti sjell rekord levizjesh: 2.4 milione të huaj viz
fundit

Hoxha nga Nju Jorku: Bashkëpunimi rajonal, domosdoshmëri për sigurinë dhe mirëqenien në Ballkanin Perëndimor



25 Shtator 2026, 14:51 Politika TEMA



Në kuadër të Sesionit të 81-të të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ferit Hoxha, mori pjesë në diskutimin mbi forcimin e bashkëpunimit rajonal, të organizuar në kuadër të Kryesive të Rumanisë të Iniciativës së Evropës Qendrore (CEI) dhe Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP).

Ministri Hoxha theksoi se në një botë të formësuar nga pasiguria në rritje, lufta, kërcënimet hibride, sulmet kibernetike dhe presionet ekonomike, përgjigjja jonë duhet të jetë e qartë: më shumë bashkëpunim, jo fragmentim; më shumë dialog, jo konfrontim; dhe më shumë veprime praktike, bëri me dije zyra e shtypit e Ministrisë së Jashtme përmes një njoftimi për mediat.

Sipas Hoxhës, bashkëpunimi rajonal nuk është më vetëm një çështje marrëdhëniesh të fqinjësisë së mirë, por një domosdoshmëri strategjike.

“Për Shqipërinë, bashkëpunimi rajonal mbetet një gur themeli i politikës sonë të jashtme dhe një investim strategjik në paqen, sigurinë, qëndrueshmërinë dhe prosperitetin e Ballkanit Perëndimor dhe Evropës në tërësi”, tha Hoxha.

Për ministrin e Jashtëm, bashkëpunimi rajonal dhe anëtarësimi në BE ndërlidhen reciprokisht.

“Lidhjet më të forta rajonale ndihmojnë në avancimin e perspektivës evropiane, ndërsa perspektiva e anëtarësimit në BE ofron një shtysë të fuqishme për bashkëpunim, reformë dhe lidhshmëri. Besimi mundëson bashkëpunimin, bashkëpunimi forcon qëndrueshmërinë dhe qëndrueshmëria krijon mundësi për qytetarët tanë”, përfundoi Ministri.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Mbërrin në Shqipëri Eric Wendt, ambasadori i ri i SHBA-së, ja kur kur i dorëzon letrat kredenciale Presidentit Begaj](#)

14:38 Politika / 3 komente

["Jo propagandë, përgjegjësi dhe transparencë"- PD reagon për mbledhjen e Këshillit të Sigurisë nga Presidenti](#)

14:20 Politika / 3 komente

[Deputetja socialiste i del në mbrojtje Klodiana Lalës: SPAK ta trajtojë me përparësi kallëzimin e gazetares ndaj Vlora Hysenit](#)

14:00 Politika / 15 komente

[Kapetanović nga Nju Jorku: Bashkëpunimi provohet kur politika bëhet e vështirë](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.